



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 599/4 prot.

Tiranë më 27.07.2020

VENDIM

Nr. 25, datë 27.07.2020

PËR KONTROLLUESIN "STUDIO MODERNA ALBANIA" SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar (në vijim, "Ligji"), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (në vijim, "Kodi i Procedurave Administrative"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Studio Moderna Albania" SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 86, datë 04.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "Komisioneri"), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Studio Moderna Albania" SHPK (në vijim, "Kontrolluesi"), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetas, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave dhe zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Hetimi administrativ, pranë kontrolluesit, u fokusua në:

- (i) trajtimin e ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga subjekti i të dhënave personale, që pretendon përdorimin e të dhënave të tij personale në tejkalim të qëllimit për të cilin të dhënat janë grumbulluar (vetëm për pjesëmarrjen në konkursin e quajtur "Gjumashi") nga ana e Kontrolluesit, në kundërshtim me parashikimet e Ligjit; dhe
- (ii) verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga Kontrolluesi, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtari tregtare, ndër të tjera, në fushat *“teleshopping, import-eksport, tregtimin e mallrave dhe shërbimeve etj.”*.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave *“punëmarrës”, “punonjës të larguar”, “kandidatë për punë”* dhe *“klientë”*. Të dhënat përpunohen manualisht, si dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

Kontrolluesi përdor një aplikacion, i cili mundëson telefonata hyrëse (*inbound*) dhe dalëse (*outbound*). Klientët plotësojnë të dhënat e tyre (*emër, mbiemër, datëlindje, numër telefoni, adresë e-maili*), në rast se kërkojnë të kontaktohen nga Kontrolluesi.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës, u konstatua që Kontrolluesi ka zhvilluar një konkurs të quajtur *“Gjumashi”*, për promovimin e dyshekëve të gjumit. Në kuadër të këtij konkursi, Kontrolluesi ka mbledhur të dhëna personale të aplikantëve (ndër të cilët, edhe të dhënat e ankuesit), të tilla si *emër, mbiemër, gjinia, mosha, numër telefoni, adresë e-mail dhe informacione të tjera rreth aplikantit/es*.

Zyra e Komisionerit, verifikoi përpunimin e të dhënave personale në kuadër të zhvillimit të konkursit *“Gjumashi”*, listën emërore të punonjësve që kanë patur akses në këto të dhëna dhe punonjësve të tjerë, si dhe listën e numrave zyrtarë të telefonit të Kontrolluesit.

Në përfundim, rezultoi se numri i telefonit që ka kontaktuar ankuesin nuk i përket Kontrolluesit dhe emri i personit objekt ankese nuk është punonjës i tij. Gjithashtu, nuk u provua që të dhënat e ankuesit (në kuadër të ankesës) të jenë përhapur në mënyrë të paligjshme.

3. Për kategorinë e subjekteve *“punonjës të larguar”, “kandidatë për punë”* dhe *“klientë”*., Kontrolluesi nuk parashikon asnjë afat për mbajtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parimin e parashikuar në germën “d” të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011, të Komisionerit *“Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 11”*) dhe Udhëzimin nr. 42 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 42”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi ka detyrimin të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar të dhënat personale. Në momentin që qëllimi ka përfunduar, lind detyrimi që Kontrolluesi, vetë ose nëpërmjet delegimit të një pale të tretë në cilësinë e përpunuesit, të realizojë



shkatërrimin/fshirjen e të dhënave, në të kundërt, përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

4. Kontrolluesi, në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, ka instaluar një sistem video survejimi (CCTV). Në total janë instaluar 6 kamera, 1 në ambientet e brendshme të zyrave, 4 në ambientet e dyqanit dhe 1 në dhomën e serverit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të video survejimit, në ambientet e punës së punëmarrësve, cenon privatësinë e këtyre të fundit dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së përpunimit të të dhënave, të sanksionuar në germën "c" të pikës 1 të nenit 5 të Ligjit, Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 3*"), dhe Udhëzimin nr. 11. Sistemi i video survejimit duhet të konsiderohet si mjete i fundit për të realizuar qëllimin e përpunimit.

5. Kontrolluesi, nuk i informon subjektet e të dhënave "*kandidatë për punë*", në lidhje me të drejtat e tyre sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit, për mënyrën e përpunimit të të dhënave, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim dhe/ose fshirje të të dhënave, si dhe të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave. Kjo, në kundërshtim edhe me Udhëzimin nr. 42.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit, por konstatohet se ato nuk përmbajnë elementët e mjaftueshëm për informimin e subjekteve mbi përpunimin e të dhënave, sipas parashikimeve në nenin 18, të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 mbi "*Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 3*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson atyre njohjen me të drejtat që iu janë akorduar me Ligj, si dhe iu mundëson, gjithashtu, ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi, nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

6. Kontrolluesi ka në administrim faqen e internetit <https://www.topshop.al>, për reklamimin e produkteve dhe regjistrimin e klientëve të rinj nëpërmjet formës së regjistrimit përkatës. Për krijimin e llogarisë, klientët duhet të përdorin të dhëna personale si *emër, mbiemër, gjinia, adresa, qyteti, numër telefoni dhe adresë e-mail*.

Kontrolluesi nuk ka vendosur një rubrikë për "Politikat e Privatësisë", në faqen e tij të internetit, me qëllim informimin e subjekteve që aksesojnë këtë faqe, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit.



Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e privatësisë” (në një formë dhe gjuhë të kuptueshme), pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes së internetit. Në këtë kuadër, publikimi i “Politikave të privatësisë” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

7. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket:

- i. Deklarimin në rubrikën 3, “*Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*” të tilla si “*punonjës*”, “*vizitorë*”, etj.;
- ii. Deklarimin në rubrikën 4, “*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*” të tilla si “*imazhe nëpërmjet kamerave të sistemit CCTV*”;
- iii. Deklarimin në rubrikën 5, “*Të dhënat sensitive që përpunohen*” të tilla si “*të dhëna shëndetësore*”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 7, “*Marrësi i të dhënave personale*”, drejt të cilëve kontrolluesi i përhap të dhënat në zbatim të detyrimeve ligjore si dhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit apo delegimit të përpunimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim dhe përditësimi i formularit të njoftimit, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

8. Kontrolluesi ka hartuar “*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”. Dokumenti i hartuar nga Kontrolluesi është identik me Rregulloren tip të publikuar në faqen e internetit, të Zyrës së Komisionerit dhe në përmbajtjen e saj, nuk parashikohen rregulla specifike mbi të gjitha proceset përpunuese që kryhen Kontrolluesi, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen



rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

9. Kontrolluesi nuk ka marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe vërehet mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr.47, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit “*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 48*”), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka paraqitur pretendimet me shkrim, për shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Sa i përket pretendimeve të Kontrolluesit se grupi i hetimit e ka zhvilluar hetimin administrativ mbi bazën e një urdhri me objekt të përcaktuar që lidhet me verifikimin e ankesës, por e ka shtrirë hetimin në të gjithë aktivitetin e shoqërisë duke dalë jashtë kompetencave të tij, Zyra e Komisionerit sqaron se në Urdhrit nr. 86, datë 04.06.2020, i nxjerrë për hetimin administrativ të Kontrolluesit, është përcaktuar qartë se objekti i hetimit administrativ pranë këtij të fundit do të jetë verifikimi i ankesës së subjektit të të dhënave personale, si dhe zbatimi i Ligjit. Në këtë rast, ashtu si edhe në raste të tjera të ngjashme, me qëllim verifikimin në tërësi të respektimit të parimeve, të drejtave dhe



detyrimeve të parashikuara në ligj, Zyra e Komisionerit e ka shtrirë objektin e hetimit përtej ankesës.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39, pika 1, gërmat "a", "b", "d" dhe "dh", të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) *Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me Kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 15.000 deri në 500.000 lekë;*
- b) *Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) *Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) *Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 27, 29, 30, 39 (pika 1, gërmat "a", "b", "d" dhe "dh") si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit.
2. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit.
3. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit.
4. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin dhe zbatimin në praktikë të afateve për ruajtjen e të dhënave personale për kategoritë e subjekteve, të dhënat personale të të cilëve ai përpunon, duke përcaktuar edhe procedurat e shkatërrimit dhe/ose fshirjes së



tyre pas përfundimit të këtij afati, në zbatim të nenit 5 të Ligjit. Për këto afate të informohen edhe subjektet e të dhënave;

5. Kontrolluesi, të shkatërrojë të dhënat e mbledhura për subjektet e të dhënave “kandidatë për punë”, “klientë” dhe “punonjës të larguar”, të cilat përpunohen në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit.
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 5 të Ligjit, të ndalojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit të pozicionuar në ambientet e punës së punëmarrësve, si dhe të heqë kamerat e pozicionuara në këto ambiente.
7. Kontrolluesi të shkatërrojë të dhënat imazhe-video, të grumbulluara nëpërmjet kamerave të pozicionuara në ambientet e punës së punëmarrësve, në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit;
8. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë, etj;
9. Kontrolluesi të marrë masat për vendosjen e tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të video survejimit sipas standardit të miratuar në Udhëzimin nr. 3 dhe në zbatim të nenit 18 të Ligjit;
10. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet publikimit në faqen online në internet të “Politikave të Privatësisë”, në një formë dhe gjuhë të kuptueshme;
11. Kontrolluesi të kryejë përditësimin e njoftimit për ndryshmin e gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjëse, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
12. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të parashikojë në “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., për çdo proces përpunimi dhe për çdo subjekt të të dhënave personale;
13. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e personelit të tij, si dhe sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të krijohet në përputhje me standardin ISO/IEC 270001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, si dhe mund të certifikohet, për qëllime përputhshmërie me standardin në fjalë, nga

organizma të akredituar dhe autorizuar në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi. Në këtë rast, Kontrolluesi, në zbatim të germës "b" të pikës 42 të Udhëzimit nr. 47, depoziton pranë Zyrës së Komisionerit një kopje të certifikatës së përputhshmërisë;

14. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32, të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- (i) menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikat 5, 6 dhe 7 më sipër;
- (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 4, 8, 9, 10 dhe 12 më sipër; dhe
- (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 13.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

15. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

16. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.

17. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më 27.07.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

